

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklaratat - Berisha falënderon diasporën në SHBA: Janë të gatshëm për të mbështetur përpjekjet për t ë çmontuar këtë regjim
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917809/berisha-falenderon-diasporen-ne-shba-jane-te-gatshe-m-per-te-mbeshtetur-perpjekjet-per-te-cmontuar-kete-regjim/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 10:50:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 10:29:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1d7460371e7411c2db9774d76ece1cfaa6ee2375d06e5d762e90cd3ca0b577d2
TEKSTI	2e18c596ed08af2e28572caf0b45db9fb93131976fdf69596152a60be0265cf0
PAMJA	8f1871c188b0e8d3d1e79ef2d0689a3eec0105ac5dfcc1bea188d98fa27fd941

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b39a9ec021d3d15b359cc96619a252df24a3f0e50ee2b1b8b8901f0fb107e1c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0b332b3aa7ecfa1fb91f9dd35095ec558c07d306f6207fe4bc42429a4dfb028
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b39a9ec021d3d15b359cc96619a252df24a3f0e50ee2b1b8b8901f0fb107e1c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.



Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAFAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

LAJMI I FUNDIT**LIVE/ Kryetari i PD, Prof. Dr. Sali Berisha, bashkëbisedim me qytetarët në rrjetet sociale****më të lexuarat****'Akuza të stisura politikisht', Saiti:**
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës**Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç****Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës****By Pass i Elbasanit/ 'Karakaçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen****'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'****Ligji për statusin e magistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i****Berisha falënderon diasporën në SHBA:
Janë të gatshëm për të mbështetur
përpjekjet për të çmontuar këtë regjim**

12:29, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN**Pas një vizitë të suksesshme në SHBA, kreu i opozitës shqiptare Sali Berisha ka falënderuar diasporën në SHBA.****"Janë të gatshëm për të mbështetur përpjekjet e opozitës për të çmontuar këtë regjim", tha kreu demokrat.****Berisha:** Faktikisht, këtë javë që lamë pas u zhvillua një hearing në Kongresin e SHBA, hearing në të cilin kryetari i Komisionit të Helsinkit të këtij Kongresi, kongresmeni Xho Uillson shtroi pyetje shumë të rëndësishme mbi krimin transnacional, përdorimin e mjeteve publike dhe ndikimin e tyre në zgjedhjet në Shqipëri.

Pra, mund të themi se me takimet tona, ne paraqitëm realitetin shqiptar sipas versionit tonë të opozitës, por që në fakt duhet të them se nuk është se ato ranë si rrufe në qiell të pasur. Njohuritë për Shqipërinë ishin mjaft të avancuara.

Mund t'u them se Sekretari Rubio, në mesazhin e tij që i dërgon Edi Ramës për pavarësinë e Shqipërisë, shprehet se kartelet e drogës, bashkëpunëtorët e tyre dhe organizatat kriminale janë një rrezik për qytetarët amerikanë dhe duhet t'i luftojmë me efikasitet.

Po kështu, lufta kundër korrupsionit është një problem tjetër madhor, për të cilin administrata e presidentit Trump e ka shprehur në mënyrë të përsëritur shqetësimin e saj.

Me këtë rast, dua të shpreh mirënjohjen më të thellë miqve tanë në Partinë Republikane, IDU-së për ftesën dhe mikpritësitë në takimet e rëndësishme që patëm.

Por, dua të jem i sqartë, pjesa më emocionale e udhëtimit tim ishin takimet me diasporën tonë të mrekullueshme.

Takime që rikthyen atmosferën e zjarrtë të viteve '90-'91, kur së bashku me diasporën bëmë gjithçka për të përmbysur diktaturën komuniste në Shqipëri.

Në atë kujtim, e kujtoj gjithnjë, ne kërkuam ndihmën dhe mbështetjen e saj për të rrëzuar diktaturën komuniste në Shqipëri dhe çlirimin e Kosovës.

Diaspora dha kontribut historik.

Kombi aty ka disa nga personalitetet më të shquara të atdhetarisë, të çështjes kombëtare.

Por njëloj kësaj here, me të njëjtin entuziazëm, me të njëjtin shpirt vëllazërie na pritën së bashku me Fatmir Mediun, Belind Këlliçin, Enri Çenon, Klevis Balliun dhe Albana Vokshin.

Një pritje e jashtëzakonshme. Një angazhim i madh, një preokupim i madh i tyre për gjendjen në Shqipëri dhe vendosmëri për të kontribuar në mënyrë që shqiptarët të shpëtojnë nga diktatura autoritare e Edi Ramës dhe narkoshteti i tij.

E njëjta atmosferë në Dallas, në Teksas. Më pak numerike, por jo më pak aktive. Po aq atdhetare dhe e flaktë, diaspora jonë në Dallas dhe në Teksas. Personalitete të shquar të cilët kanë kontribuar shumë si për Shqipërinë, ashtu edhe për çlirimin e Kosovës.

Të gatshëm të kontribuojnë përsëri me të gjitha lidhjet e tyre të fuqishme me ligjvënësit amerikanë, me zyrtarët amerikanë për çmontimin e narkoshtetit në Shqipëri, por edhe për problematikat me të cilat përballet Kosova.

Pra, mund t'u them se ky udhëtim i fillimit të shtatorit të vitit 2026, ndonëse ishte 35 vite larg të parit, për sa i përket rëndësisë dhe për sa i përket mikpritjes vëllazërore, ngjasonin shumë njëri me tjetrin.

Me këtë rast, dua të përshëndes të gjithë përfaqësuesit tanë të shkëlqyer në diasporë për atë pritje jashtëzakonisht të ngrohtë që na rezervuan dhe angazhimin e tyre të plotë për të mbështetur përpjekjet e forcave demokratike dhe opozitës për çmontimin e këtij regjimi.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vendimet e Gjykatës Speciale/ Berisha: Asgjë nuk e nxin luftën çlirimtare të Kosovës



Vizita në SHBA/ Berisha: Fjalimi i Trump, mbështetje për ata që përballen me komunizmin dhe kartelet e drogës



Meta: Aktgjyrimi ndaj krerëve të UÇK, turpi i drejtësisë ndërkombëtare. Hapat ligjorë që duhet të ndjekë Kosova e Shqipëria

pakonsultuar me asuje...



'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi



Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur



'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

TË NGJASHME



Ekonomia ecën mirë vetëm për atë që ka një koncesion, për të tjerët është provë mbijetese



'Nuk janë sardele'/ Zhupa: 70 fëmijë në një klasë, Saranda e nis vitin me kaos në kopshte e çerdhe



Të rroftë emri...



Shteti shqiptar përsëri në Arbitrazh/ Ministria e Kulturës fsheh konfliktin në gjykatën ndërkombëtare



Mësuesja e arrestuar në Shqipëri me urdhër të Erdoganit/ Kolegët dhe nxënësit e saj protestojnë në Francë



Korrupsioni mbetet 'thembra e Akilit' në Kadastër



Diaspora ngrihet sot në protesta në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.